



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 1259/prot
2

Tiranë, më 21/09 2020

URDHËR

Nr. 178/datë 21.09 2020

MBI

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 722, DATË 11.11.2019 "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS, TË KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT PERSONAL DHE TË STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE E TË DETYRAVE TË TYRE"

Bazuar në ligjin nr.57/2019, "Për Asistencën Sociale në RSH", pikat 4 dhe 16 të kreut IV të vendimit nr.722, datë 11.11.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre", gërmat "a", "b", "c" dhe "ç" të pikës 2 të kreut IV të vendimit nr. 431, datë 8.06.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot", i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 135, datë 7.03.2018, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Statusit të Shërbimit Social Shtetëror",

URDHËROJ:

1. Pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 2, të kreut IV, të vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 të Këshillit të Ministrave, është 11,541 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.
2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma "a", të kreut IV, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 6,907 (gjashtëmijë e nëntëqind e shtatë) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.
3. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma "b", të kreut IV, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 9,209 (nëntëmijë e dy qind e nëntë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.

